



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1450, datë 12.11.2010

Për

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Eagle Mobile sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a.”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 12.11.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Eagle Mobile sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a,

BAZA LIGJORE:

1. Neni 120, i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Nenet 66-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 416, datë 07.12.2007, e ndryshuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i'u referuar bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N :

- I. Eagle Mobile sh.a., me shkresën nr. 3280 prot. i AKEP, datë 3.11.2010, i është drejtuar AKEP me kërkesën, për urdhërimin e Vodafone Albania sh.a (në vijim Vodafone) për të lidhur marrëveshje interkoneksioni me Eagle Mobile sh.a., duke vënë në dispozicion të AKEP gjithë informacionin në lidhje me korrespondencën e shkresave me Vodafone si më poshtë vijon:
1. Shkresë e Eagle Mobile sh.a., nr. 4045 Prot., datë 22.09.2010, “Dërgohet draft Marrëveshja e interkoneksionit Vodafone-Eagle Mobile”;
 2. Shkresë e Vodafone CEO/0085/EXH, datë 28.09.2010, “Përgjigje shkresës tuaj nr. 4045 Prot., datë 22.09.2010, mbi kërkesën për lidhje interkoneksioni”;
 3. Shkresë e Eagle Mobile sh.a., nr. 4598 Prot., datë 21.10.2010, “Në lidhje me Marrëveshjen e interkoneksionit Vodafone-Eagle Mobile”;
 4. Shkresë e Vodafone CEO/0110/EXH, datë 25.10.2010, “Përgjigje shkresës tuaj nr. 4598 Prot., datë 22.09.2010, mbi kërkesën për lidhje interkoneksioni”;
 5. Komunikimet elektronike mes palëve Eagle Mobile-Vodafone në vijim të negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes së interkoneksionit (*email-et e datave 4, 8 dhe 14 Tetor 2010*).
- II. Në korrespondencën e lartpërmendur vërehet se:
1. Eagle Mobile, me shkresën nr. 4045, datë 22.9.2010, ka dërguar draft marrëveshjen e interkoneksionit me Vodafone, për periudhën 1.8.2010-31.7.2011;
 2. Vodafone, me shkresën CEO/0085/E.Xh, datë 28.9.2010, i përgjigjet shkresës së datës 22.9.2010, të Eagle Mobile, duke dërguar draft marrëveshjen e interkoneksionit për periudhën 1.4.2010 - 31.3.2011, duke theksuar qëndrimin e njëjtë të komunikuar edhe në shkresat e mëparshme. Ky i fundit është i vlefshme edhe për tarifën e terminimit të zbatueshme për rrjetin e Eagle Mobile. Gjithashtu në këtë shkresë, Vodafone kërkon edhe të dhënat për përlllogaritjen e garancisë bankare;
 3. Eagle Mobile, me email-n e datës 8.10.2010, kërkon aplikimin e tarifës prej 13.32 Lekë/min., deri më datë 24.7.2010.
 4. Eagle Mobile, me shkresën nr. 4598, datë 21.10.2010, dërgon draft marrëveshjen e interkoneksionit me Vodafone për periudhën 1.8.2010 - 30.9.2011, me tarifë terminimi 12.92 lek/minutë, sipas VKD 1346 të AKEP. Hyrja në fuqi e së cilës është sqaruar me VKD të AKEP nr. 1404, dt. 23.9.2010;

5. Vodafone, me shkresën CEO/0110/E.Xh. datë 25.10.2010, dërgon draft marrëveshjen e interkoneksionit me Eagle Mobile, për periudhën 1.4.2010 - 31.3.2011. Dërgon, gjithashtu, llogaritjen e garancisë bankare.
- Vodafone, pretendon lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit që prej dt. 1.4.2010, për të mos patur asnjë muaj të marrëdhënieve të pambuluar me Marrëveshje, sic e kërkon ligji 9918 datë 19.05.2010;
 - Vodafone, pretendon:
 - o Për periudhën 1.4.2010-28.5.2010, të zbatohet tarifa 13.32 Lekë/min., sipas marrëveshjes së dt. 1.4.2009, (sic është përmendur edhe në email-in e datës 4.10.2010);
 - o Për periudhën 28.5.2010-24.7.2010, të zbatohet tarifa 12.2 Lekë/min., sipas VKD të AKEP nr. 1212, datë 31.3.2010;
 - o Prej datës 24.7.2010, pranon implementimin e tarifës 12.9 Lekë/min., sipas VKD të AKEP nr. 1346, datë 23.7.2010;
 - Në rast të tranzitimit të trafikut ndërkombëtar nga Eagle Mobile drejt rrjetit të Vodafone, në marrëveshjen e interkoneksionit duhet parashikuar edhe ndarja e kapaciteteve të interkoneksionit kombëtar dhe ndërkombëtar;

Sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a dhe Vodafone Albania sh.a, me gjithë përpjekjet për të negociuar dhe lidhur marrëveshjen e interkoneksionit, këmbëngulin në mënyrë të vazhdueshme në qëndrimet e tyre si me poshtë:

- Tarifën e terminimit në rrjetin e Eagle Mobile për periudhën nga data 01.04.2010 deri më 24.7.2010,
 - dhe datën e lidhjes së marrëveshjes se re që do të nëshkruhet midis palëve;
6. Kërkesa e depozituar nga Eagle Mobile në AKEP, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit mbeshtetet në nenin 50 dhe 60 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 7 i Rregullores “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” si dhe pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Eagle Mobile dhe Vodafone Albania sh.a.
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar

- Ded Jakaj Anëtar
- Florida Cela Anëtar
- Xhenisa Nela Anëtar

3. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit;

4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al,

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alketa MUKAVELATI

2. Benon PALOKA

3. Ibsen ELEZI

4. Zamira NURÇE